



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, **Gzim Ademaj**, menaxher i Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;
Dhe

"**SHKËMBI**" SHPK nga Istogu, të cilën e përfaqëson z. **Musa Metaj**, me Nr. Rexh. Biznesi, 810296039 (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

ASFALTIMI I RRUGËS KOSH – OSOJAN-vazhdim projekti

Nr. I prokurimit	633-20-4993-5-3-5/ C409
Nr. I brendshëm	633 / 020 / 075 / 521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

ASFALTIMI I RRUGËS KOSH – OSOJAN-vazhdim projekti

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi I kontrtës per aktivitetin e prokurimit ASFALTIMI I RRUGËS KOSH – OSOJAN-vazhdim projekti është 9.644,00 € dhe me shkronja: /Nëntëmijëegjashtëçindekatërdhjetëkatërzerozeroeuro/ €

2.2 Çmimi që do t'i paguhet kontraktorit është **9.485,00 €**, sa është edhe zotimi i mjeteve për këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa vlera prej **159,00 €** e pa permbushur nga kontrata, bëhet nëse sigurohet burimi i financimit

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës:

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Kohëzgjatja e Kontratës:

4.1. Të gjitha punimet sipas kësajë kontrate do të përfundojnë me datë, **21.11.2020**

Neni 5. Ndërprerja e kontratës:

5.1 Kjo kontratë mund të shkëputet kurdo që kontraktori nuk i respekton kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës të parapara në dosjen e tenderit, dhe kur për një gjë të tillë plotësohen këto kushte, duke pasqyruar edhe sanksionet e parapara për dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues.

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për

pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.





5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të

interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për Kontraktuesin:
"Shkëmbi" Shpk

Emri:	Gëzim Ademaj	Emri:	Musa Metaj
Pozita: <i>UD</i>	Menaxher-it i Prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	19. 11. 2020	Data:	19. 11. 2020
Vu la		Vu la	

Numri i Prokurimit: 633/20/087/535– Titulli : NDERTIMI I TRIBINAVE NE STADIUMIN E FUTBOLLIT DEMUSH MAVRAJ-ISTOG -pune shtese

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <i>[shëno emrin, adresen e menaxherit të Projektit]</i>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është <i>[shëno 10%]</i> i vlerës së kontratës.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Ofruesi i Shërbimeve do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do të sigurojë Autoritetin kontraktues dhe Menaxherin e Projektit kundër, çdo kërkesë për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ofruesi i shërbimit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tij.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	n/a
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) vendim nga gjyqi; ose b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK. a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

ANEXI "KOSH-OSOJAN"

Krahu 1

B=5.0 m.

2240m'

Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi Total
				€	€
1	Prerja e shkurreve ne dy anet e rruges	m'	2240	0.60 €	1,344.00 €
2	Hapja e kanaleve ne te dy anet e rruges dhe transporti I materjalit deri ne deponi.	m'	4300	1.00 €	4,300.00 €
3	Punimi I bankinave me zhavor 0-31.	m ³	400	10.00 €	4,000.00 €
1	Prerja e shkurreve ne dy anet e rruges				1,344.00 €
2	Hapja e kanaleve ne te dy anet e rruges dhe transporti I materjalit deri ne deponi.				4,300.00 €
5	Punimi I bankinave me zhavor 0-31.				4,000.00 €
TOTALI ME TË GJITHA NGARKESAT					9,644.00 €